



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E HETIMIT ADMINISTRATIV

Nr. 646/prot.
6

Tiranë më 20.05.2019

VENDIM

Nr. 09, datë 20.05.2019

PËR KONTROLLUESIN "BIOCHECK DIAGNOSTIC CENTER"

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, neneve 77-112 të ligjit nr.44/2015 "*Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", si dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit "*Biocheck Diagnostic Center*".

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 125 datë 23.04.2019 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, më datë 03.05.2019 u krye hetim administrativ pranë kontrolluesit "*Biocheck Diagnostic Center*", me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë kontrolluesit "*Biocheck Diagnostic Center*", konstaton se:

1. Kontrolluesi ka "*Njoftuar*" Zyrën e Komisionerit në lidhje me përpunimin e të dhënave personale, në zbatim të neneve 21 dhe 22 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar, por konstatohet nevoja e përditësimit të formularit të njoftimit në rubrikën "*personi i kontaktit*".
Konstatimi përbën shkelje administrative të pikës 1 të nenit 21 dhe nenit 22 të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*" i ndryshuar: "*...Njoftimi duhet të bëhet para se kontrolluesi të përpunojë të dhënat për herë të parë ose kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji, të njoftuar më parë*".

Përditësimi i njoftimit është një nga detyrimet më të rëndësishme ligjore i cili në vështrim të nenit 21 të ligjit, duhet të kryhet kur kërkohet ndryshimi i gjendjes së njoftimit të përpunimit, sipas nenit 22 të këtij ligji.

2. Kontrolluesi, nuk ka hartuar një rregullore "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*".

Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", pika 2/1: "*Kontrolluesi është i detyruar të dokumentojë masat tekniko-organizative të përshtatura dhe të zbatuara për garantimin e mbrojtjes së të dhënave personale, në përputhje me ligjin dhe rregullore të tjera*".

Duhet kuptuar drejt nga kontrolluesi rëndësia që ka hartimi i një rregulloreje të mirëfilltë për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe përdorimi i saj nga nëpunësit e tij, si një akt bazë i cili ndërgjegjëson dhe detyron punonjësit për ruajtjen e konfidencialitetit, ruajtjen nga keqpërdorimi dhe mënyrën e administrimit të të dhënave personale.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "*dh*" të ligjit nr. 9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

3. Kontrolluesi nuk ka administruar deklaratat e konfidencialitetit të punonjësve. Konstatimi përbën shkelje administrative të nenit 28 të ligjit nr.9887/2008 "*Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale*", i ndryshuar: *Kontrolluesit, përpunuesit dhe personat, që vihen në dijeni me të dhënat e përpunuara, gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, detyrohen të ruajnë konfidencialitetin dhe besueshmërinë edhe pas përfundimit të funksionit. Këto të dhëna nuk përhapen, përveç rasteve të parashikuara me ligj, dhe Vendimit nr.06 të Komisionerit.*

Qëllimi i nënshkrimit të kësaj deklarate është fakti që të gjithë punonjësit të cilët kanë akses në informacione lidhur me të dhënat personale, të tyre apo të klientëve, të kuptojnë qartë dhe drejtë detyrimet që ata kanë për ruajtjen e konfidencialitetit. Në aktin e formalizuar me titull "*Deklaratë Konfidencialiteti*", dalë në zbatim të Vendimit nr. 6/2013 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për sigurimin e të dhënave personale*", merren përsipër të drejta dhe detyrime lidhur me mos transferimin në mënyrë abuzive të të dhënave personale tek personat e paautorizuar. Me nënshkrimin e një akti të tillë, synohet ndërgjegjësimi i plotë i deklaruesit ndaj punëdhënësit për ruajtjen e të dhënave personale, të dhënat që i mëson për shkak të detyrës apo pozicionit që ka, si dhe paralajmërohet marrja e masave të menjëhershme administrative në rast të shkeljes së këtij standardi.

Mos kryerja në kohë e këtij detyrimi, ngarkon kontrolluesin me kundërvajtje administrative dhe dënohet me gjobë nga 10.000 deri në 150.000 lekë, sipas nenit 39, pika 1, gërma "*dh*" të ligjit nr.9887/2008 "*Për mbrojtjen e të dhënave personale*", i ndryshuar.

4. Konstatohet se kontrolluesi informon nëpërmjet tabelave subjektet e të dhënave "nëpunës", "vizitorë", etj., mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV), por tabela nuk është e standardizuar sipas Udhëzimit nr. 3/2010 të Komisionerit "Për përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera".

Modeli standard i miratuar ka për qëllim informimin e subjektet të të dhënave, mbi përpunimin e të dhënave imazhe-video, ushtrimin e të drejtës së subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë etj.

5. Kontrolluesi nuk ka vendosur politikat e privatësisë me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave të cilët aksesojnë këtë portal. Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Informacioni i publikuar në "Politikat e Privatësisë", duhet të ketë për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave që vizitojnë këtë portal, mbi mënyrat e përpunimit të të dhënave, masat e sigurisë, ruajtjen e konfidencialitetit, të drejtat e subjekteve të të dhënave dhe detyrimet e kontrolluesit në kuadër të mbrojtjes së privatësisë.

Në kryerjen e hetimit administrativ, u mbajt në konsideratë fakti se, me Rekomandimin nr. 39 datë 28.10.2013 të Komisionerit, ndaj Kontrolluesit "Biocheck Diagnostic Center sh.p.k", është rekomanduar:

1. Të merren masa për hartimin e rregullores për mbledhjen, mbrojtjen, përpunimin e të dhënave personale.
2. Të bëhet ndryshimi në kontratat e punës së punonjësve duke përfshirë pikën në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave të pacientëve, si dhe të administrohet në dosjet e punonjësve deklarata e konfidencialitetit e nënshkruar.

Nëpërmjet shkresës nr. 1186/7 prot., datë 04.12.2013, kontrolluesi ka dërguar pranë Zyrës së Komisionerit dokumentacionin mbi rikuperimin e detyrave të lëna, por gjatë kontrollit të ushtruar më datë 03.05.2019, rezultoi se këto akte janë fiktive, pra nuk është realizuar. Sa më sipër, grupi i hetimit administrativ konstatoi në procesverbal mungesën e tyre.

Në përfundim të kontrollit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit ka hartuar procesverbalin e konstatimit (datë 03.05.2019), të cilin përfaqësuesi i kontrolluesit e ka nënshkruar me komentit: "Angazhohemi për realizimin e detyrave brenda datës 10.05.2019".

Me shkresën nr. 646/3 datë 8.05.2019 kontrolluesi ka parashtruar pranë Zyrës së Komisionerit pretendimet në lidhje me konstatimet e hetimit administrativ, ku ka dokumentuar:

1. Përditësimin e formularit të njoftimit;
2. Publikimin e politikave të privatësisë në portalin www.biocheck-al.com

3. *Vendosjen e tabelave informuese mbi sistemin e video-survejimit (CCTV), sipas standardit të miratuar me Udhëzimin nr.03/2010 të Komisionerit;*
4. *Hartimin e rregullores për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale.*

Në zbatim të neneve 87-89 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", kontrolluesi "Biocheck Diagnostic Center" është njoftuar të marrë pjesë në seancë dëgjimore në datën 16.05.2019 pranë ambjenteve të Zyrës së Komisionerit.

Kontrolluesi është paraqitur në seancë, ku ka argumentuar të njëjtat pretendime që ka paraqitur më parë në rrugë shkresore, si dhe ka dokumentuar rikuperimin e shkeljes administrative të nenit 28, duke depozituar "deklaratat e konfidencialitetit", të punonjësve të tij.

Si përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ të cilat konsistojnë në mungesën e politikave të privatësisë, deklaratave të konfidencialitetit të punonjësve dhe rregullores specifike "Për mbrojtjen, përpunimin, dhe ruajtjen e të dhënave personale", në kuptim të nenit 39, pika 1, germat "b" dhe "dh" të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për Mbrojtjen e të dhënave personale", përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohet me gjobë si më poshtë:

- b) *kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;*
- dh) *"Kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10.000 deri në 150.000 lekë".*

Në zbatim të nenit 39/2 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", për kundërvajtjet e mësipërme administrative, kontrolluesi dënohet me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka mbajtur parasysh faktin se shkeljet e konstatuara janë serioze. Ato lidhen me garantimin e parimeve dhe përpunimin e ligjshëm të të dhënave. Megjithatë, është marrë në konsideratë fakti që kontrolluesi është treguar bashkëpunues me grupin e kontrollit, ka reaguar pas konstatimit të shkeljeve si dhe ka përmbushur detyrimet për kërkesat ligjore, duke ndikuar në përcaktimin proporcional të masës së sanksionit.

PËR KËTO ARSYE:

Në zbatim të neneve 18, 27, 28, 29, 30, 39 pika 1 gërmat "b" dhe "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar,

VENDOSA:

1. Dënimin e kontrolluesit "Biocheck Diagnostic Center" me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetëmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
2. Dënimin e kontrolluesit "Biocheck Diagnostic Center", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 27 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
3. Dënimin e kontrolluesit "Biocheck Diagnostic Center", me gjobë në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë për shkelje të detyrimeve të përcaktuar në nenin 28 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar.
4. Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e afatit të ankimit, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
5. Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky vendim u shpall sot më 20.05.2019

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

